



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 31001-00255-00-2015 i Regj. Themeltar  
Nr. 00-2017-2270 i Vendimit (845)**

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Medi Bici	Anëtar
Tom Ndreca	Anëtar

sot më datë 14.11.2017, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen që i përket:

**PADITËS:** Shoqëria “\*\*\*”, sh.a., në mungesë;

**TË PADITUR:** 1. Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, në mungesë;  
2. \*\*\*, në mungesë;

**OBJEKTI:** Shfuqizimin e patentës nr. \*\*\*, datë \*\*\*, me titull “Skema e Kthimit të vajit mbetës të reaktorëve në solar të pastër”;

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr. 9947, date 07.07.2008, “Për pronësinë industriale”, neni 32, 43, 325 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, me vendimin nr. 8814, datë 29.07.2013, ka vendosur: *Rrëzimin e kërkesëpadisë.*

**Gjykata e Apelit Tiranë**, me vendimin nr. 1932, datë 07.05.2014, ka vendosur: *Të shpallë moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për gjykimin e çështjes me nr. 5074/2363 Regj. Themeltar, datë 23.10.2013 dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit.*

**Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2765, datë 03.07.2014, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. 8814, datë 29.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

**Kundër vendimit nr. 2765, datë 03.07.2014**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala paditëse, e cila ka kërkuar ndryshimin e të dy vendimeve, pranimin e padisë dhe shfuqizimin e patentës nr. 00970, datë 10.05.2004, me titull “Skema e Kthimit të vajit mbetës të reaktorëve në solar të pastër”, duke parashtruar këto shkaqe:

- Vendimet nr. 2765, datë 03.07.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit dhe nr. 8814, datë 29.07.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, janë të pambështetura në prova dhe në ligj;
- Pretendimi se pala paditëse nuk ka ezauruar rrugën administrative dhe për këtë shkak nuk mund t'i drejtohet gjykatës nuk qëndron pasi, referuar nenit 57 të ligjit nr. 7819, datë 27.04.1994 “Për pronësinë industriale”, zgjidhja e mosmarrëveshjeve për zhvlerësimin e patentës është vetëm në ekskluzivitetin e gjykatës;
- Parashikimi i nenit 26 të këtij ligji, për t’iu drejtuar Bordit të Apelimit të Zyrës së Patentave për kundërshtimin e patentës, nuk është një hallkë administrative e detyrueshme për tu ndjekur por alternative;
- Ekskluziviteti i gjykatës për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve qëndron edhe në faktin se, në bazë të nenit 21/1 të ligjit në fjalë, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave nuk bën një shqyrtim thelbësor të kërkesës për patentë për shkak të mungesës së kapaciteteve të nevojshme tekniko – shkencore e materiale dhe për këtë shkak patenta lëshohet pa garanci për vlefshmërinë e saj;
- Studimi i paraqitur si shpikje nga i padituri \*\*\* ka qenë pjesë e procesit teknologjik të prodhimit të Solarit që në vitin 1990 dhe se asgjë e re nuk është sjellë nëpërmjet këtij studimi;
- Studimi i të paditurit ka sjellë në vetvete diçka praktike në zbatimin e teknologjisë që njihet dhe zbatohet pranë KPTHN por nuk ka sjellë ndryshime esenciale teknologjike që të mund të kualifikoheshin si novacion apo hap shpikës;
- Në të tilla kushte shpikja nuk mund të jetë e patentueshme dhe për këtë shkak është lëshuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave pa asnjë lloj garancie për sa i përket vlefshmërisë së saj;
- Në lidhje me dokumentacionin e domosdoshëm teknik që shoqëron ndryshime të tilla teknologjike në rafinerinë e naftës Ballsh nuk është gjetur asnjë kopje e studimit fillestar origjinal dhe asnjë lloj oponence si dhe nuk ka asnjë skemë teknologjike të miratuar nga Dega Teknike, që të përfshijë ndryshimet lidhur me temën e realizuar;
- Patenta nr. \*\*\*, datë 10.05.2004, me titull “Skema e Kthimit të vajit mbetës të reaktorëve në solar të pastër” është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7819, datë 27.04. 1994 “Për pronësinë industriale” dhe për rrjedhojë kjo patentë duhet të shfuqizohet si e pavlefshme;
- I padituri \*\*\* nuk mund të përfitojë nga aplikimi i ligjit nr. 7819, datë 27.04.1994 “Për pronësinë industriale” pasi ky ligj nuk i shtrin efektet për marrëdhëniet e punës të lindura përpara vitit 1990.

## KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Xhezair Zaganjori, në mungesë të palëve ndërgjyqëse, dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi;

### V Ë R E N

1. Në fillim të viteve 90, disa punonjës të KPTHN Ballsh (filial i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a.), konkretisht i padituri \*\*\* dhe dy punonjës të tjerë, kanë dhënë një propozim në fushën e teknologjisë dhe të solarit, propozim i cili u pranua dhe u vu në zbatim nga Byroja Teknologjike e ndërmarrjes së KPTHN Ballsh (Kombinati i Përpunimit të Thellë të Naftës Ballsh) në vitin 1990, periudhë në të cilën ende legjislacioni shqiptar në fuqi nuk kishte njohur e rregulluar “pronësinë industriale”. Propozimi i bërë nga grupi i punonjësve konsistonte në lehtësimin teknologjik të procesit ekzistues të prodhimit të solarit.

2. I padituri \*\*\*, rezulton se është një ish punonjës i shoqërisë \*\*\* sh.a, Tiranë. Ai ka punuar në sektorin e naftës si punëmarrës i palës së paditur në disa detyra, pranë KPTHN Ballsh, duke filluar që në vitet 70, si në detyrat e teknologut etj.

3. Duke filluar që në vitin 2004 ka aplikuar pranë Drejtorisë së Patentave dhe Markave, për pajisjen me patente (patentimin) në lidhje me shpikjen e kryer prej tij që konsistonte në ndryshimin e skemës teknologjike në impiantin e KPTHN Ballsh dhe konform ligjit është patentuar me patentën nr. \*\*\*, datë 10.05.2004, për shpikjen me titull “Skema e kthimit të vajit mbetës të reaktorëve në solar të pastër”.

4. Që në momentin e aplikimit për patentimin e shpikjes së mësipërme e ka shoqëruar aplikimin e vet edhe me aprovimin dhe dokumentacionin e lëshuar nga përfaqësuesit e punëdhënësit KPTHN Ballsh. Pas patentimit, patentat e të paditurit \*\*\*, është regjistruar rregullisht në regjistrin e patentave.

**5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, me vendimin nr. 8814, datë 29.07.2013, ka vendosur: *Rrëzimin e kërkesëpadisë.*

5.1. Në marrjen e këtij vendimi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka arsyetuar se nuk rezultoi e provuar në gjykim që pala paditëse t’i ishte drejtuar më parë me ankim Bordit të Apelit të Zyrës së Patentave. Gjithashtu rezulton të ketë kaluar afati prej 9 muajsh, i parashikuar në nenin 26 të ligjit nr. 7819, datë 27.04.1994 “Për pronësinë industriale”, që pala paditëse të mund t’i drejtohej këtij organi. Në të njëjtën kohë pala paditëse nuk solli asnjë provë me të cilën të provonte paligjshmërinë e patentës nr. \*\*\*, datë 10.05.2004, të lëshuar nga pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave. Së fundi, pala paditëse nuk provoi interesin e saj të ligjshëm për t’iu drejtuar gjykatës me këtë padi.

**6. Kundër vendimit nr. 8814, datë 29.07.2013**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka bërë ankim pala paditëse, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe rrëzimin e padisë.

**7. Gjykata e Apelit Tiranë**, me vendimin nr. 1932, datë 07.05.2014, ka vendosur: *Të shpallë moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për gjykimin e çështjes me nr. 5074/2363 Regj. Themeltar, datë 23.10.2013 dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit.*

**8. Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2765, datë 03.07.2014, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. 8814, datë 29.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

**9. Kundër vendimit nr. 2765, datë 03.07.2014**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala paditëse, e cila ka kërkuar ndryshimin vendimeve, pranimin e padisë dhe shfuqizimin e patentës nr. \*\*\*, datë 10.05.2004, me titull “Skema e Kthimit të vajit mbetës të reaktorëve në solar të pastër”, duke parashtruar shkaqet e prezantuara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

## VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se shkaqet e parashtruara në rekurs nga ana e palës paditëse, Shoqëria “\*\*\*\*”, sh.a., nuk janë të tilla që do ta bënë të cenueshëm vendimin nr. 2765, datë 03.07.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit.

11. Vendimi nr. 2765, datë 03.07.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit, me të cilin është lënë në fuqi vendimi nr. 8814, datë 29.07.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton të jetë një vendim i drejtë dhe i marrë në përputhje me ligjin.

12. Nga hetimi gjyqësor i zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit rezulton se i padituri \*\*\*, në bazë të kërkesës së tij është pajisur nga i padituri tjetër, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, me një patentë, në datën 10.05.2004, për shpikjen e emërtuar “Skema e Kthimit të vajit mbetës të reaktorëve në solar të pastër”.

13. Nga ana e palës paditëse, Shoqëria “\*\*\*\*”, sh.a., është kundërshtuar në rrugë gjyqësore lëshimi i kësaj patente në emër të paditësit, duke pretenduar se risia e sjellë prej tij në procesin e riciklimit të vajit nuk kualifikohet si shpikje. Legjitimitimin e saj pala e paditëse e mbështet në faktin se me të paditurin \*\*\* ajo është në një proces tjetër gjyqësor, në të cilin ky i paditur, paditës në atë gjykim, pretendon të drejtat ekonomike që rrjedhin nga shfrytëzimi i shpikjes së tij prej shoqërisë “\*\*\*\*”, sh.a.

14. Të dyja gjykatat, si ajo e shkallës së parë ashtu edhe Gjykata Administrative e Apelit, e kanë rrëzuar padinë me argumentin se pala paditëse nuk i ishte drejtuar më parë Bordit të Apelimit të Zyrës së Patentave, si organ administrativ epror ndaj palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave dhe se kishte kaluar afati prej 9 muajsh për t’iu drejtuar këtij organi. Gjithashtu gjykatat janë shprehur edhe për pathemelësinë e padisë dhe mungesën e legjitimitetit të palës paditëse.

15. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon të ndalet fillimisht në çështjen e juridiksionit si parakusht procedural që duhet të merret në shqyrtim përpara se të vlerësohet themeli i mosmarrëveshjes. Një pretendim i tillë rezulton të jetë ngritur edhe në rekurs nga ana e palës paditëse.

16. Në ndryshim nga qëndrimi i mbajtur nga gjykatat e faktit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor. Në të kundërt gjykatat nuk duhet të ishin shprehur me rrëzimin e padisë por me nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, gjykata e shkallës së parë, ose prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes, Gjykata Administrative e Apelit.

17. Në nenin 57 të Ligjit nr. 7819, datë 27.04.1994, “Për pronësinë industriale”, përcaktohet juridiksioni ekskluziv i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga një patentë. Ky përcaktim i ligjit, “juridiksioni ekskluziv”, ka të bëjë si me faktin se kundërshtimi i një patente mund të kryhet si drejtpërdrejt në gjykatë (juridiksioni), ashtu edhe me faktin se e vetmja gjykatë kompetente për shqyrtimin e këtyre mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (kompetenca).

18. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon të theksojë se parashikimi i nenit 26 të ligjit për depozitimin, përpara Bordit të Apelimit, të kundërshtimit për lëshimin e patentës, nuk ka efekt detyrues dhe nuk përbën një ankim në kuptim të ezaurimit të rekursit administrativ përpara se subjekti t'i drejtohet gjykatës, për tre arsye.

19. Së pari, nga vetë përmbajtja e dispozitës, interpretimi gjuhësor i saj, konstatohet se fjala e përdorur është e natyrës lejuese “ka të drejtë”. Pra, kjo mënyrë e ndërtimit të fjalisë dhe fjalë e zgjedhura nuk e vënë subjektin pretendues përpara detyrimit për të ndjekur rrugën administrative, përpara se t'i drejtohet gjykatës, me pasojën nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor nga kjo e fundit.

20. Së dyti, vetë ligji nuk i jep Zyrës së Patentave kompetencë të plotë për t'i bërë kërkesës për patentë një vlerësim thelbësor të novacionit ose risisë së pretenduar. Për këtë shkak, me interpretim logjik arrijmë në përfundimin se edhe Bordi i Apelimit nuk ka kompetencë të plotë për të vlerësuar thelbin e shpikjes për të cilën kërkohet lëshimi i patentës, për sa kohë këtë kompetencë të plotë nuk e ka as organi që i lëshon patentat. Në këtë kuadër, kompetenca e Bordit të Apelimit kufizohet vetëm në vlerësimin e aspekteve formale të lëshimit të patentës, pa i hyrë kushteve të vlefshmërisë.

21. Së treti, nga përfaqja e këtyre dy dispozitave krijohet përshtypja se ligji ka kundërthënie, ku në njërin anë përcakton një organ administrativ më të lartë dhe afate të shkurtra, të ngjashme me ato të ankimeve administrative, për të shqyrtuar kërkesën për shfuqizimin e një patente dhe nga ana tjetër i jep gjykatës juridiksion ekskluziv për shqyrtimin e të gjitha mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga një patentë, duke përfshirë edhe atë për zhvlerësimin e saj (neni 46).

22. Në këtë aspekt, gjykata pavarësisht kundërthënies në dukje (*prima facie*) të ligjit, nuk mund të refuzojë të japë zgjidhje për çështjen. Ajo duhet t'i bëjë ligjit interpretimin që i bën të përputhshëm dispozitat në dukje kontradiktore dhe jo të lërë pa zbatuar një ose disa dispozita me argumentin që vijnë në kundërshtim me një ose disa dispozita të tjera. Zgjidhja e dytë do të ishte në kapërcim të misionit të saj të dhënies së drejtësisë, duke shkelur sakaq parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve, pasi do të linte pa fuqi dispozita të ligjit të miratuara me vullnetin e ligjvënësit, pa u shprehur ky i fundit për pushimin e fuqisë juridike të tyre.

23. Lënia pa fuqi e një ose disa dispozitave të ligjit mund të bëhet nga ligjvënësi ose duke i shfuqizuar në mënyrë të shprehur në një ligj të ri ato ose duke miratuar një të tillë që vjen në kundërshtim me të parin, i cili e shfuqizon atë në bazë të parimit universal *lex posteriori derogat lex priori*. Për dispozita që ndodhen në të njëjtin ligj dhe që janë miratuar në të njëjtën kohë nuk mund bëhet fjalë për lënie pa fuqi të njëra – tjetrës. Në këtë rast është detyrë e gjykatës, që nëpërmjet metodave të interpretimit tu japë kuptim të gjitha dispozitave të një ligji.

24. Megjithatë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, arrin në përfundimin se vendimi nr. 2765, datë 03.07.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit, duhet të lihet në fuqi për shkak se pala paditëse nuk ka arritur të provojë legjitimitetin e saj në ngritjen e padisë. Legjitimiteti substancial është një tjetër aspekt që merret në konsideratë nga gjykata përpara shqyrtimit të meritave të çështjes, pra bazueshmërisë në prova dhe në ligj të padisë.

25. Të dyja gjykatat e faktit në vendimet e tyre arritën në përfundimin se pala paditëse nuk arriti të provonte interesin e saj të ligjshëm në ngritjen e padisë. Në këtë kontekst, i binte barra e provës kësaj pale, që nëpërmjet provave të sjella në gjykimin në fakt, të provonte këtë interes, pra se çfarë i cenohej kësaj pale nga ekzistenca e patentës në emër të paditësit.

26. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë thekson se misioni i saj si gjykatë ligji nuk është vlerësimi i provave apo konstatimi i fakteve në mënyrë të ndryshme nga gjykatat më të ulëta, por vetëm kontrolli mbi mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit si dhe respektimit të standardeve të procesit të rregullt ligjor nga ana e tyre.

27. Për sa më sipër, duke qenë se nga gjykatat e faktit nuk rezultoi i provuar legjitimiteti i palës paditëse, atëherë ky Kolegj nuk ka juridiksion për të shqyrtuar çështjet e tjerë të shtruara në rekurs. Për këtë shkak, vendimi nr. 2765, datë 03.07.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit, nuk mund të jetë subjekt i vlerësimeve të mëtejshme për sa kohë nuk konstatohen të meta të cilat mund të përbëjnë shkak rekursi për në Gjykatën e Lartë.

28. Së fundi, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i tërheq vëmendjen gjykatave më të ulëta në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjeve nga ana tyre. Nëse gjykata e shkallës së parë ose gjykata e apelit konstaton se çështja, sipas vlerësimit të saj, është jashtë juridiksionit gjyqësor, atëherë nuk mund të vazhdojë me vlerësimin e aspekteve të tjera të saj, por duhet ta përfundojë gjykimin me një vendim jopërfundimtar, i cili është nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit për gjykatën e shkallës së parë dhe pushimi i gjykimit për gjykatën e apelit. Në të njëjtën mënyrë vlerësohen me radhë edhe elementët e tjerë, si kompetenca, parashkrimi, më tej legjitimimi dhe në fund meritat e çështjes.

29. Kryerja e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm nga ana e gjykatës nuk duhet të përkthehet me dhënie përgjigje të gjitha pretendimeve dhe prapësimeve të palëve, pasi mungesa e një prej parakushteve procedurale e pengon atë në shqyrtimin e themelit të çështjes.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 63, shkronja “e”, të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;

## **V E N D O S I**

Lënien në fuqi të vendimit nr. 2765, datë 03.07.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 14.11.2017